



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

Nr. Prot.

Lënda: Kërkesë për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

Drejtuar: Komisionit Rregullator

Z.Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve

Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator,

I nderuar Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve,

Me vendimin nr. 10, datë 23.12.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Po në nenin 12 pika 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: **“Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmbledhen me kërkesë të çdo anëtari”**.

Neni 20, pika 1, shkronja “dh” e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Në nenin 24, pika 5 të Kodit zgjedhor përcaktohet se: **“Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit, me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”**.



Neni 25, pika 1 dhe 12, parashikon se: *Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, **në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij**, si dhe parashikon gjithashtu **kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e akteve të nevojshme normative nënligjore** për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.*

Neni 46, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikojnë se: *Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.*

Nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me nenin 11 pika 6 dhe nenin 16 të “Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit Rregullator”, po ju paraqesim këtë kërkesë, për vetëmbledhjen sa më parë të Komisionit Rregullator, me qëllim shqyrtimin e projekt aktit me objekt “Për një shtesë në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TE NDRYSHUAR”. Sjellim në vëmendjen tuaj afatin e ngushtë të mbetur ndaj kërkojmë mirëkuptimin **që kjo mbledhje të thirret me urgjencë e pa humbur aspak kohë.**

Helga VUKAJ

Anëtar i Komisionit Rregullator

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar i Komisionit Rregullator